



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.53/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fato Ademi kryesuese, Afijete Sada-Gillogjani dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lart Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me apelin e Arsić Vojin, për shkak të mos përfshirjes në listën e votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 22.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si i pabazuar apeli Anr.53/2019. i Arsić Vojin, paraqitur kundër KQZ për shkak të mos përfshirjes në listën e votuesve jashtë Kosovës.

A r s y e t i m

Komisioni Qendror i Zgjedhje me datë: 19.09.2019 ka miratuar listën përfundimtare për votuesit jashtë Kosovës.

Me datë 20 shtator 2019 parashtruesi i apelit Arsić Vojin, ka parashtruar ankesë kundër vendimit të KQZ të datës: 19.09.2019 kur është miratuar lista përfundimtare e votuesve, me pretendimin se i njëjti edhe pse kishte aplikuar me datë: 06.09.2019 për të hyrë në listë të votuesve jashtë Kosovës, me rastin e publikimit të listës nuk e ka gjetur emrin e tij në listë. I njëjti thekson se në të gjitha zgjedhjet e mëparshme të përgjithshme ka pasur drejtë për të votuar, ndërsa në këtë rast është refuzuar paligjshëm.

Arsić Vojin,

Në përgjigjen e KQZ-se të datës 21.09.2019 theksohet se parashtruesi i apelit Arsić Vojin, ka dërguar kopje të dokumentit të identifikimit se bashku me formularin por nuk por nuk e ka dërguar një kopje të dokumentit identifikues me të cilin dëshmohet se plotëson njërin nga kriteret juridike për tu përfshirë në listën e votuesve jashtë Kosovës.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimit e apelit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i pabazuar pasi që parashtruesi i apelit gjate aplikimit të tij për regjistrim për votim jashtë Kosovës nuk ka ofruar dosjen e kompletuar dhe nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara siç parashihet me dispozitat e LZP-së dhe të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.53/2019 më datën 22.09.2019.

Kryesuese e Panelit
Faton Ademi



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.